



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit

P- 110

Prishtinë, më 13 maj 2010

PROCESVERBAL

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 13 MAJ 2010

Seancën e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 73 deputetë dhe deklaroi të hapur punimet e sajë.

Kryetari, në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës ia uroi deputetit Sabri Hamiti Urdhrin “Gjergj Kastriot Skënderbeu”, me të cilin e kishte dekoruar Presidenti i Shqipërisë.

Në fillim të seancës, për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Deputeti **Ismet Beqiri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, i uroi deputetit Sabri Hamiti Urdhrin “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, të dekoruar nga Presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi.

Deputeti, **Gani Geci**, ngriti çështjen e protestës së minatorëve të Trepçës një ditë më parë në Prishtinë, lidhur me pagat e tyre.

Deputeti, **Lulzim Zeneli**, ngriti çështjen e prapambetjes në zhvillimin ekonomik dhe infrastrukturor të zonave kufitare, me theks të veçantë të zonës së Gollakut. Ai tha se rreth 40 fshatra janë të izoluara nga mungesa e infrastrukturës rrugore në këtë zonë.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit i seancës plenare, të mbajtur më 29 prill 2010
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pagat e nëpunësve civilë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për eficiencën e energjisë,
7. Shqyrtimi i Propozim-amendamenteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar,
8. Debat për gjendjen në ndërmarrjet publike qendrore, sipas mocionit të deputetit Driton Tali, të mbështetur edhe nga 11 deputetë të tjerë,
9. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, për vitin 2009 ,
10. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2009,
11. Shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për barazi gjinore.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 29 prill 2010

Procesverbali i seancës plenare të mbajtur më 29 prill 2010, u miratua me vërejtjen e deputetit Riza Smaka, në faqen nr. 1 të këtij Procesverbali, që është korrigjuar sipas kërkesës së tij.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Donika Kadaj-Bujupi** parashtroi pyetje për kryeministrin **Hashim Thaçi** lidhur me procedimin e Projektligjit të punës në Kuvend nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Kadaj-Bujupi.

Deputetja **Suzana Novoberdaliu** parashtroi pyetje për ministrin **Skender Hyseni** lidhur me notat verbale të ardhura në MPJ, sikur nota verbale e shtetit të Swazilandit.

Ministri Hyseni nuk ishte prezent në seancë, kështu që pyetjes së deputetes Novoberdaliu nuk iu përgjigj askush nga Qeveria.

Deputeti **Heset Cakolli** parashtroi pyetje për ministrin **Ahmet Shala** lidhur me atë se a janë në përputhshmëri Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/2 me Udhëzimin administrativ nr. 2008/08 për homologimin e automjeteve.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Cakolli.

Deputeti **Heset Cakolli** parashtoi pyetje për ministrin **Bajram Rexhepi** lidhur me pajisjen e qytetarëve të Kosovës me tabela të regjistrimit të automjeteve.
Ministri Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetit Cakolli.

Deputeti **Xhevdet Neziraj** parashtoi pyetje për ministrin **Sadri Ferati** lidhur me emërimin e zëvendëskryesuesit në Kuvendin Komunal të Fushë Kosovës.
Ministri Ferati iu përgjigj pyetjes së deputetit Neziraj.

Deputeti **Naser Rugova** parashtoi pyetje për ministrin **Blerand Stavileci** lidhur me kërkesën e Qeverisë komunale të Istogut për ndërtimin e një rruge lokale në atë zonë, me interes për sektorin e bujqësisë.
Ministri Stavileci iu përgjigj pyetjes së deputetit Rugova.

Deputetja **Gjylnaze Syla** parashtoi pyetje për kryeministrin **Hashim Thaçi** lidhur me kohën e procedimit në Kuvend të Projektligjit për pronën.
Ministri Ahmet Shala iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputeti **Driton Tali** parashtoi pyetje për ministrin **Enver Hoxhaj** lidhur me tenderin për pajisjen e shkollave me teknologji informative.
Ministri Hoxhaj nuk ishte prezent në seancë, kështu që pyetjes së deputetit Tali nuk iu përgjigj askush nga Qeveria.

Deputetja **Luljeta Shehu** parashtoi pyetje për ministrin **Blerand Stavileci** lidhur me projektin për sistemin e ujitjes së rreth 600 hektarëve të tokës bujqësore në disa fshatra të komunës së Prizrenit dhe të Suharekës, në të ardhmen.
Ministri Stavileci iu përgjigj pyetjes së deputetes Shehu.

Deputeti **Adem Hajdaraj** parashtoi pyetje për ministrat Enver Hoxhaj apo Edita Tahiri lidhur me mos zbatimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shtyrjen e moshës për punë të profesorëve universitarë.
Ministria Edita Tahiri tha se është e gatshme të përgjigjet në seancën e radhës, pasi që nuk e ka marrë pyetjen e deputetit Hajdaraj.

Deputeti **Riza Smaka** parashtoi pyetje për zëvendës kryeministrat **Hajredin Kuçi** apo **Ramë Manaj** lidhur me masat që duhet të ndërmerren për miratimin e akteve ligjore sa më të sakta dhe shprehimisht më të qarta, Ai si shembull përmendi Ligjin nr. 03/L-134 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare.
Zëvendës kryeministri Ramë Manaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Riza Smaka** parashtoi pyetje për ministrin **Haki Demolli** lidhur me mos zbatimin e aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës nga ana e disa komunave për çështjet juridiko-pronësore, të referuara si “uzurpime arbitrare të paluajtshmërive shoqërore”.
Ministri Demolli iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputetja **Teuta Hadri** parashtoi pyetje për ministrin **Bujar Bukoshi** lidhur me dëmin e shkaktuar në aparatura nga një shpërthim i tubit të ujit në Institutin e Onkologjisë.
Ministri Bukoshi iu përgjigj pyetjes së deputetes Hadri.

Deputetja **Teuta Hadri** parashtoi pyetje për ministrin **Nenad Rashiç** lidhur me planet në skemën e ndihmës sociale të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, pas

marrëveshjes së nënshkruar me autoritetet gjermane për kthimin e dhjetë mijë romëve të paraqitur si kosovarë.

Ministri Rashiq iu përgjigj pyetjes se deputetes Hadri.

Deputeti **Naim Rrustemi** parashtroi pyetje për ministrin **Sadri Ferati** lidhur me prononcimet e këtij të fundit për një vendim të Komunës së Prishtinës për Qendrën Kardiake Private në afërsi të QKU-së.

Ministri Ferati iu përgjigj pyetjes se deputetit Rrustemi.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi kryetarin e komisionit funksional që ta arsyetojë raportin para deputetëve të Kuvendit.

Deputeti **Esat Brajshori** tha se pas seancës plenare të 29 prillit 2010, ku shqyrtimi i këtij Projektligji dhe i atij për pagat e nëpunësve civilë u shtynë për seancën plenare të radhës, ishte i nevojshëm harmonizimi i qëndrimeve të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media me Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Këto dy komisione kanë formuar Grupin punues për harmonizimin e qëndrimeve. Rekomandimet nga ky grup punues i kemi pranuar si dy komisione dhe sot gjenden para deputetëve, për shqyrtim. Ai kërkoi nga Kuvendi miratimin e këtyre rekomandimeve.

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e komisionit funksional.

Kuvendi miratoi të gjitha amendamentet e propozuara në Projektligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nga amendamenti nr. 1 deri te amendamenti nr. 67.

Kryesuesi në vazhdim hodhi në votim tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----80,
Kundër-----1,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pagat e nëpunësve civilë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e komisionit funksional që ta arsyetojë raportin para deputetëve të Kuvendit.

Deputeti **Hajredin Hyseni** tha se pas seancës plenare të 29 prillit 2010, kemi bërë harmonizimin e çështjeve diskutabile me Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si dhe me Komisionin për Buxhet dhe Financa. Ai tha se gjithashtu kemi pasur parasysh edhe vërejtjet e sindikatës përkatëse dhe i ftoi deputetët t'i miratojnë amendamentet e propozuara.

Deputeti **Gani Koci**, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa paraqiti opinionin për këtë pikë të rendit të ditës.

Pasi nuk pati deputetë të tjerë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e komisionit funksional.

Kuvendi miratoi të gjitha amendamentet e propozuara në Projektligjin për pagat e nëpunësve civilë, nga amendamenti nr. 1 deri te amendamenti nr. 42.

Kryesuesi, në vazhdim, hodhi në votim tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----79,

Kundër-----0,

Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për pagat e nëpunësve civilë.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme

Kryesuesi ftoi ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin.

Ahmet Shala, në fillim tha se kjo nismë ligjore e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa është pjesë e Strategjisë legjislative të Qeverisë së Kosovës për këtë vit.

Në vazhdim, tha se me qëllim të arritjes së objektivave tona, kemi paraparë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, në pajtim me praktikat më të mira dhe konventat ndërkombëtare.

Më tej, ai potencoi se ky projektligj parasheh procedimin e ankesave në gjykatë, procedurat dhe afatet kohore lidhur me këtë çështje.

Ministri tha se pas miratimit, përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji do të jetë MEF-i dhe MTPT-ja, kurse në fund i ftoi deputetët për miratimin, në parim, të Projektligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nerxhivane Dauti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar “7+” Xhezair Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Nekibe Kelmendi, Gani Koci, Bahri Hyseni dhe Driton Tali, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----63,

Kundër-----1 ,

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Projektligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për eficiencën e energjisë

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për eficiencën e energjisë.

Zëvendëskryeministri **Ramë Manaj** tha se Projektligji për eficiencën e energjisë parashihet edhe nga Projektligji për energjinë, i cili është miratuar në Kuvend, në parim, para pak kohësh.

Projektligji është i harmonizuar me direktivat evropiane nr. 2006/32 dhe nr. 2008/92, tha zëvendëskryeministri.

Qëllimi i këtij projektligji është rregullimi i infrastrukturës ligjore dhe institucionale, masat për mbrojtjen e mjedisit etj.. Po ashtu, parashihet krijimi i Agjencisë për Eficiencën e Energjisë, tha ai.

Më tej konstatoi se ky Projektligj vendos praktikën nga legjislacioni evropian, nuk ka kosto të lartë, si dhe ka marrë pëlqimin nga Traktati i Athinës për Energjinë, kurse në fund i ftoi deputetët ta miratojnë, në parim, Projektligjin për eficiencën e energjisë.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për eficiencën e energjisë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha - Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Et'hem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar "7+", Shpresa Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Driton Tali, Naim Rrustemi dhe Bujar Dugolli, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----68,

Kundër-----2 ,

Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për eficiencën e energjisë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe

Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i Propozim-amendamenteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar

Deputeti **Gani Koci**, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, arsyetoi para deputetëve të Kuvendit Raportin me rekomandime për ndryshimin dhe plotësimin e Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, Kryesuesi i hodhi në votim propozim-amendamentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----83,
Kundër-----1,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Ratifikohen ndryshimet dhe plotësimet e Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtarë, si në vijim:

1. Propozim amendamenti mbi Zëshmërinë (fuqinë) dhe Pjesëmarrjen (Vendimi nr. 63-2);
2. Propozim amendamenti mbi Autoritetin e Investimeve (Vendimi nr. 63-3);
3. Propozim amendamenti i katërt i neneve (i Marrëveshjes) mbi Alokimin e Veçantë të Njëhershëm të “SDR” (të drejtës speciale të tërheqjes).

II. Ngarkohet Qeveria e Republikës së Kosovës që t'i marrë të gjitha veprimet në zbatim të këtyre ndryshimeve të Marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

8. Debat për gjendjen në ndërmarrjet publike qendrore, sipas mocionit të deputetit Driton Tali, të mbështetur edhe nga 11 deputetë të tjerë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e grupit të deputetëve nënshkrues, që në emër të propozuesit para Kuvendit të arsyetojë mocionin për debat.

Deputeti **Driton Tali**, fillimisht tha se pak më shumë se para dy viteve, Qeveria kishte përmendur KEK-un, ANP-në dhe PTK-në, si ndërmarrje më të korruptuara në vend dhe bëri një krahasim me gjendjen aktuale në këto ndërmarrje.

Në vazhdim, tha se Zyra e Shërbimeve të Brendshme e OKB-së pati raportuar për keqpërdorime në ANP, mirëpo një menaxhim i tillë akoma po vazhdon. Për pasojë të punësimit pa kurrfarë kriteri, sot kemi numër të mbipunësimit në ANP, kurse ai më pas bëri një krahasim ndërmjet numrit të punësuarve në aeroportin e Prishtinës me numrin e

të punësuarve në aeroportin e Beogradit dhe atë të Shkupit, dhe realizimeve financiare në këto tri aeroporte.

Duke folur më tej për gjendjen në këtë ndërmarrje, ai pyeti se çka do të ndodhë me punëtorët e aeroportit të Prishtinës, pas koncesionimit?

Duke folur për gjendjen në KEK, deputeti Tali tha se 30 milion € janë dhënë në tender njëburimor, kurse në lidhje me çmimin importues të energjisë elektrike në Kosovë, tha se ai është më i shtrenjtë se në vendet e rajonit për 2.4 herë.

Më pas, duke folur për gjendjen në këto ndërmarrje, ai konstatoi se Qeveria ka zgjedhur një rrugë më të shkurtër – privatizimin e këtyre ndërmarrjeve.

Për sa i përket gjendjes në PTK, ai vlerësoi se edhe në këtë ndërmarrje nuk është gjendja aspak më e mirë, kurse si shembull mori krijimin e një operatori të tretë të telefonisë mobile, në kuadër të operatorit Vala.

Ministri **Ahmet Shala** tha se një Raport gjithpërmbledhës për gjendjen në këto ndërmarrje do të sillet në Kuvend pas përfundimit të auditimit në këto ndërmarrje.

Në vazhdim, duke folur për këtë pikë të rendit të ditës, ministri tha se kufiri i ndikimit të grupit ndërministror në këto ndërmarrje përfundon kur zgjedhën anëtarët e bordit të këtyre ndërmarrjeve, kurse nga ana e Qeverisë, në këto ndërmarrje nuk mund të ndërhyhet më shumë se sa lejon ligji.

Në fund, ai tha se çdokush që ka të dhëna çfarë i paraqiti z. Tali, ka adresë ku ato duhet të paraqiten.

Kryesuesi hapi debatin për gjendjen në ndërmarrjet publike qendrore.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Berim Ramosaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Suzana Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, kryeministri Hashim Thaçi si dhe deputetët: Behxhet Pacolli, ministri Ahmet Shala, Naim Rustemi, Kaqusha Jashari, Gjylnaze Sylaj, Riza Smaka, Synavere Rysa, Emrush Xhemajli, Xhevdet Neziraj, Fatmir Rexhepi, Ibrahim Gashi, Besa Gaxherri, Qamile Morina, Gani Buçinca, Rita Hajzeraj-Beqaj, Zef Morina, Sala Berisha-Shala, Sabri Hamiti dhe Driton Tali, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Kryesuesi, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, mbylli punimet e seancës së sotme në orën 18:35, për t'i vazhduar më 17 maj 2010, në ora 10:00.

E hënë, 17 maj 2010

Vazhdimi i seancës plenare

Seancën e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Për fjalë u paraqit kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së.

Ramë Buja në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së kërkoi harmonizimin e nenit 44 me nenin 47 të Rregullores së Punës së Kuvendit, të mirtaur në seancën plenare të 29 prillit 2010.

Kjo kërkesë e deputetit Ramë Buja u përkrah nga kryetarët ose përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare: **Naser Osmani** nga LDK, **Ahmet Isufi** nga AAK, **Suzana**

Novoberdaliu nga AKR, **Lulzim Zeneli** nga LDD, **Xhezair Murati** nga “7+”, **Petar Miletiq** nga SLS dhe **Numan Baliq** nga Grupi Parlamentar për Integritet.

Kryetari Konstatoi se kjo pikë radhitet si pikë nr. 12 e rendit të ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi i vazhdoi punimet me shqyrtimin e pikës nr. 9 të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2009

Deputetja **Myzejene Selmani**, në emër të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion arsyetoi para deputetëve të Kuvendit Raportin me rekomandime lidhur me Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2009.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjona, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zef Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Et'hem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Enis Kervan, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Naim Rustemi, Driton Tali, Abdyl Ymeri, Riza Smaka, Gani Buçinca, Shkumbin Demaliaj dhe Bahri Hyseni, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2009.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----45,
Kundër-----11,
Abstenime-----6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2009.

10. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2009

Deputetja **Myzejene Selmani**, në emër të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion arsyetoi para deputetëve të Kuvendit Raportin me rekomandime lidhur me Raportin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2009.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport, dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zef Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, ndërsa

në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Naim Rrustemi, Suzana Novoberdaliu, Xhavit Haliti, Driton Tali, Gjylnaze Sylja, Hestet Cakolli, Emrush Xhemajli, Rita Hajzeraj-Beqaj, Bujar Dugolli, Kaqusha Jashari, Rexhep Hoti, Qamile Morina, Armend Zemaj, Mimoza Ahmetaj, Riza Smaka, Abdyl Ymeri, Nekibe Kelmendi, Sanije Aliaj, Gani Buçinca, Gani Geci, Ramadan Avdiu, Sala Berisha-Shala dhe Ibrahim Gashi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** konstatoi se në mungesë të kuorumit për të votuar Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2009, votimi shtyhet për seancën plenare të radhës. Ai tha se në sallë janë prezent 59 deputetë.

11. Shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për barazi gjinore

Deputetja **Mimoza Ahmetaj**, në emër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione arsyetoi para deputetëve të Kuvendit Raportin me rekomandime lidhur me Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për barazi gjinore. Ajo tha se përmes këtij programi synohet arritja e disa objektivave me anë të një procesi gjithëpërfshirës. Edhe në aspektin e legjislacionit nga fusha e barazisë gjinore janë shënuar arritje të konsiderueshme, pas miratimit të ligjeve përkatëse në Kuvend, tha ajo.

Në vazhdim, tha se Programi për barazi gjinore është fokusuar në 6 fusha: 1) arsimimi i gjinisë femërore, 2) integrimi i gruas në ekonomi, 3) punësimi dhe përkujdesja sociale, 4) mbështetja e familjeve të varfra, 5) përkujdesja shëndetësore dhe 6) rritja e përfshirjes së femrës në vendimmarrje.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për barazi gjinore.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë program, dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Mimoza Ahmetaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Suzana Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Drita Maliqi, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Mergja, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Sanije Aliaj, Rexhep Hoti, Basri Musmurati dhe Ibrahim Makolli, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, me pëlqimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, **kryesuesi** konstatoi se në mungesë të kuorumit, shtyhet votimi për Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për barazi gjinore. Shtyhet, gjithashtu, për seancën plenare të radhës edhe shqyrtimi i pikës nr. 12 të rendit të ditës - Harmonizimi i nenit 44 me nenin 47 të Rregullores së Punës së Kuvendit, të mirtaur në seancën plenare të 29 prillit 2010.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në ora 18:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale